



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1155 Prot.

Tiranë, më 12.09 2017

VENDIM Nr. 190, datë 05.09.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, të datës 05.09.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën e ALUIZNI-it Vlorë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit shtesë anësore 3 kat banim dhe shërbim në objektin ekzistues 2 kat, të Z. Sevasti Jani Kolea dhe Gazmend Nuri Kreshpa, Lagjia "28 Nëntori", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës,

VENDOSI:

1. Të miratojë Kërkesën e ALUIZNI-it Vlorë për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit shtesë anësore 3 kat banim dhe shërbim në objektin ekzistues 2 kat, të Z. Sevasti Jani Kolea dhe Gazmend Nuri Kreshpa, Lagjia "28 Nëntori", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Vlorës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETARI KKA

RUDINA ZOTO